



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1215/ 9 Prot.,

Datë 24.06.2025

V E N D I M

Nr. 809/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar*” Marrëveshje kuadër me objekt me disa operatorë ekonomikë, me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote,

Loti 1 me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INPRESS” shpk në procedurën e prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, në lidhje me kriteret kualifikuese dhe të mbetet i skualifikuar e shtim arsye skualifikimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, me Nipt L91418502J, Adresa: Z.Kadastrale nr.8517, Ndërtese 4 kate, me sip. truallli 1000 m², Durrës.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk, me Nipt J62426002Q, Adresa: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.

- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Godina Nr.6/337, Tiranë.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik "INPRESS" shpk, me Nipt L52122014L
Adresa: Rr: "Siri Kodra", ish blloku i magazinave, Tiranë.
- Operatori ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" shpk, me Nipt L91418502J, *Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës km. i fundit, zona kadastrale nr.8517, ndërtesa 4 kate, Durrës.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues për të njëjtën procedurë prokurimi ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesa nëpërmjet Sistemit pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 20.02.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar*” Marrëveshje kuadër me objekt Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, Loti 1 me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 29.04.2025 ka vlerësuar ofertat dhe më 06.05.2025 ka përfunduar vlerësimin në SPE dhe ka kryer renditjen e tyre si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1- DYNAMICX GROUP shpk	0	Skualifikuar
2- LIBRARI DYRRAHU shpk	19,400,000	Skualifikuar
3- O F F I C E CENTER shpk	23,990,000	Skualifikuar
4- INPRESS shpk	25,334,165	Kualifikuar
5- MARKETING & DISTRIBUTION shpk	29,173,302	Kualifikuar
6- INFOSOFT OFFICE shpk	29,762,174.60	Kualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë **07.05.2025** ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5301, datë 09.05.2025 dhe me Nr. 1215/2025 Prot., date 12.05.2025 e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” shpk, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar*” Marrëveshje kuadër me objekt Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, **Loti 1** me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1215/1 prot., datë 12.05.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me shkresën ardhur në sistem, protokolluar me tonën me nr. 1215/2, datë 19.05.2025 me objekt “Formular i paraqitjes së argumenteve”, operatori ekonomik i interesuar “InfoSoft Office” shpk, kundërshton pretendimet e ankesës në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...]Referuar arsyeve të skualifikimit të OE “LIBRARI DYRRAHU” shpk, për të cilat ka deklaruar se për disa artikuj furnizohet nga subjekti “IDEA-M” shpk, për të gjithë artikujt e tjerë ka deklaruar katalogë apo link nga web të subjekteve për të cilat nuk disponon asnjë dokument. Pra, ky ofertues nuk ka deklarata nga subjekte furnitore për çmimet dhe si mund t'i sigurojë artikujt.

Sipas KVO-se nuk ka dorëzuar dokument provues mbi metodën e ndërtimit të ofertës... Referuar legjislacionit për prokurimin publik OE janë të detyruar të përmbushin kriteret për kualifikim në një procedurë prokurimi...[...]

Kërkojmë lënien në fuqi të Vendimit të KVO-së për skualifikimin e OE “LIBRARI DYRRAHU” shpk dhe refuzimin e ankesës së tij.

II.7. Me shkresat ardhur në Sistem me nr. 632/20 datë 20.05.2025 protokolluar me tonën me nr. 1215/3, datë 21.05.2025, dhe me postë me Nr. 632/22 Prot., datë. 20.05.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1215/4, datë 21.05.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë:

Vendimin e KSHA-së me Nr. 29/2025, datë 20.05.2025.

Referuar Vendimit sipërcituar KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Me shkresën nr. 1215/5 prot., datë 30.05.2025, Komisioni, referuar pretendimeve të ngritura në ankesë, i kërkoi autoritetit kontraktor kopje të shkresës dërguar operatorit ekonomik ankimues si edhe kopje të dokumenteve të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, në lidhje me sqarimet apo prova shkresore mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, për të cilën ankimuesi ngre pretendime.

II.9. Me shkresën nr. 1525/7 prot., datë 03.06.2025, protokolluar me tonën me nr.1215/6, datë 04.06.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së dokumentet si vijon:

-Kërkesën për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët, që mban dt. 18.04.2025.

-Sqarim mbi ofertën anomalisht të ulët.

-Procesverbal mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës anomalisht të ulët të OE “LIBRARI DYRRAHU” shpk.

II.10. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5318, datë 16.05.2025 dhe me Nr. 1264/2025 Prot., date 19.05.2025 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INPRESS” shpk si edhe pretendime që të mbetet i skualifikuar “LIBRARI DYRRAHU” shpk si edhe t'i shtohen arsye skualifikimi.

II.11. Bazuar në nenin 112 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e

prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1264/1 prot., datë 19.05.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.12. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me shkresën ardhur në sistem, protokolluar me tonën me Nr.1264/2, datë 20.05.2025, operatorit ekonomik “INPRESS” Shpk si subjekt i interesuar, ka paraqitur Formularin e Argumenteve në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk, me argumente si vijon:

[...] Operatori ekonomik ankimes nuk ka interes të ligjshëm për të ngritur ankesë për OE “Inpress” shpk, pasi është i kualifikuar. Gjithashtu nga vetë lloji i procedurës së prokurimit duhet të jenë në gare min. 3 OE të kualifikuar...

Kualifikimi i ofertës tonë nuk e dëmton OE ankimes,... Ankesa është abuzive [...]

II.13. Me shkresën ardhur me shërbim postar, me nr.632/28 prot., datë 27.05.2025, protokolluar me tonën me Nr.1264/3, datë 29.05.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së për ankesën Nr. 1264/2025 me arsyetim si vijon:

Me Vendimin nr. 32/2025, datë 27.05.2025 KSHA-së, ka vendosur:

Pranim i pjesshëm i ankesës e konkretisht për pikën e parë të pretendimeve për skualifikim të Operatorit Ekonomik “INPRESS” shpk, mbi mospërmbushjen të specifikimeve teknike me produktet e ofruara prej tij.

II.13.1 Me shkresën ardhur me shërbim postar, me nr.632/28 prot., datë 27.05.2025, protokolluar me tonën me Nr.1264/3, datë 29.05.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së për ankesën Nr.1264/2025 prot.

Me Vendimin nr. 32/2025, datë 27.05.2025 të KSHA-së, Pranim i pjesshëm i ankesës e konkretisht për pretendimet e ngritura për Operatorin Ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk.

II.14. Me shkresën Nr. 1264/4 prot., datë 11.06.2025, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni kërkoi nga Autoriteti Kontraktor në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...] Referuar ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk, i cili ngre pretendime për operatorë të tjerë, ... nga operatori i interesuar “INPRESS” shpk janë paraqitur Argumente në lidhje me ankesën sipërcituar në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor vërehet se KSHA ka trajtuar ankesën dhe ka marrë vendim për pranim të pjesshëm në lidhje me pretendimet e ngritura.

Përsa referuar, në bazuar të neni 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kërkohet të na informoni për sa më poshtë:

- 1. A keni njoftuar operatorin ekonomik “INPRESS” shpk mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës sipërcituar.*
- 2. Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton dërgimin dhe marrjes së vendimit nga operatori i interesuar.*

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, brenda dy ditësh nga marrja e kësaj shkrese.[...]

II.15. Me shkresën me Nr.632/35 Prot., datë 13.06.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1264/5, datë 16.06.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë informacion:

[...] Në përgjigje tuajës ju bëjmë me dije se Autoriteti Kontraktor pas vendimmarrjes së KSHA-së, respektivisht me vendimin nr 32/2025, datë 27.05.2025, nga ana e personit përgjegjës për prokurimin, janë marrë hapat për njoftimin e ankimesit, operatorëve ekonomikë të interesuar dhe Komisionit të Prokurimit Publik..... Për sa më sipër, lutemi gjeni bashkëlidhur kopje të librit të protokollit dhe dorëzimit me postë, ç'ka dëshmojnë zbatimin e detyrimit ligjor, për komunikimin dhe njoftimin e akteve administrative...[...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, me anë të së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, argumentuar si vijon:

Arsye e skualifikimit:

1.Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtim/argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban çmimi i ofertës së deklaruar;

☐ *Në dokumentacionin e paraqitur në SPE konstatohet se OE ka nënshkruar një akt-marrëveshje bashkëpunimi me subjektin “IDEA-M” sh.p.k, ku do furnizohet me të gjithë artikujt objekt prokurimi të këtij loti.*

*Nisur nga verifikimi i katalogut të dërguar në SPE, vërehet se OE vetëm për artikujt (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të DST), me nr. rendor **10, 12, 13, 14, 15, 17, 60, 61**, ka deklaruar në katalog linkun web të subjektit “IDEA-M”, ku mund të verifikohet specifikimet e artikujve të ofruara, ndërsa për të gjithë artikujt e tjerë OE ka deklaruar në katalog **linqe web të subjekteve të tjera për të cilat nuk disponon asnjë dokumentacion provues bashkëpunimi apo furnizimi.***

Në këto kushte, KVO konstaton një mospërputhje midis artikujve të deklaruar në katalog (të subjekteve të tjera) me artikujt e ofruar nga subjekti “IDEA-M” sh.p.k.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet e administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, të ndryshuar dhe arsyetimet e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SH.P.K, me NUIS L91418502J.

[...] Vlerësojmë se arsyeja e skualifikimit vlerësojmë se, arsyeja e mësipërme për skualifikim nuk qëndron dhe është në kundërshtim me Ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në datën 18.04.2025 jemi njoftuar në SPE me kërkesën e KVO-së me lëndë: Kërkesë për informacion, mbi ofertën anomalisht të ulët.

Në datën 22.04.2025 kemi ngarkuar në SPE argumentimin tonë mbi çmimet anomalisht të ulta të ofertuara nga ana jonë në këtë procedurë prokurimi, shoqëruar ky argumentin me prova

shkresore dhe analizë kosto të detajuar. Bazuar në shkresën tonë me datë 22.04.2025 me lëndë: “Sqarim mbi ofertën anomalisht të ulët dhe dokumentacionit provues” bashkëngjitur kësaj shkrese, rezulton se, operatori ynë ekonomik ka arritur të argumentojë çmimet anomalisht të ulta duke plotësuar kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar..... Referuar bilanceve pozitive në vite kemi rritje ekonomike dhe në staf, fal menaxhimit ekonomik dhe financiar. Rezulton e provuar se operatori ynë ekonomik ka arritur të argumentojë/provojë me dokumenta shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në germat a) b) c) á) të pikës 2 të nenit 93 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke i dhënë garanci dhe bindje AK, se operatorit ynë ekonomik do të përmbushë më sukses kontratën. OE Librari Dyrrahu ka dorëzuar në mënyrë të detajuar anën ekonomike të elementëve përbërës të çmimeve të ofertuara për secilin artikull, duke përcaktuar një analizë kosto të detajuar në funksion të kësaj. Në lidhje me zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve, kemi argumentuar se OE LIBRARI DYRRAHU SHPK është një shoqëri më rritje ekonomike vjetore, ka një përvojë në fushën e prokurimit disa vjeçare, për shkak të vlerës së konsiderueshme të këtij tenderi kemi bërë përpjekjet maksimale duke siguruar çmime konkurruese, duke konkluduar edhe në aktmarrëveshje me furnitorin tonë nga Kosova.

Për aq kohë sa nga ana jonë janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës... **Sa më sipër kërkojmë, shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit tonë ekonomik dhe kualifikimin e ofertës tonë si ofertë e suksesshme [...]**

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin të KSHA-së në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar si vijon: [...]

KSHA e konsideron të drejtë vendimin e KVO-së që OE Librari Dyrrahu shpk ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët e konkretisht dokumentacioni provues dhe argumentues ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit ku konstatohet fakti se subjekti “IDEA-M” shpk, me të cilin OE ka kontratë bashkëpunim, është i ndryshëm nga subjekti prodhues i deklaruar në katalogun teknik.

KSHA thekson faktin se KVO mund të refuzojë informacionin e paraqitur nga ofertuesi nëse nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj.

Sa më sipër KSHA konstaton se OE ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Për më tepër KSHA konstatoi se edhe katalogu teknike i hartuar dhe nënshkruar nga OE ankimues nuk është konform me kërkesat e AK-së sipas pikës 2.3.8. të DST.

Pra OE nuk ka deklaruar subjektin “IDEA-M” sh.p.k si prodhues edhe vetë ankimuesi e ka pranuar në ankesë.

KSHA vendosi:

1. Refuzimin e ankesës.
2. Personi përgjegjës të verë në dijeni ankimuesit, operatorët ekonomikë të interesuar dhe KPP-në.

III.1.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST shojcën 8, **2.3 Kapaciteti teknik**, Kriterin **2.3.8** *Për artikujt për të cilët nuk janë kërkuar mostra (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”), operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike, të lëshuara/publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përrputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit.*

Dokumentet standarde, F. VLERËSIMI I OFERTAVE

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët:

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

(a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

(b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

(c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përrputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përrputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në

përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit:

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 ,2 dhe 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni[....]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe ka konstatuar se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, nga përlllogaritjet e kryera, rezulton se oferta ekonomike në vlerën prej 19,400,000 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, është anomalisht e ulët dhe si rezultat e ka skualifikuar atë. Në vijim të procedurës Autoriteti Kontraktor, pas komunikimeve me operatorin ekonomik, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e operatorit ekonomik mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët duke mos pranuar argumentimin e tij.

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk me ankesën e tij ka kundërshtuar Vendimin e KVO-së.

Autoriteti kontraktor me marrjen e ankesës së operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, mori në shqyrtim pretendimet e ngritura dhe me Vendimin e KSHA-së vendosi lënien në fuqi të vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ankimuesit.

Referuar shkresave sipërcituar, Komisioni i kërkoj autoritetit kontraktor dokumentet provuese mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët të ankimuesit.

Me shkresën nr. 1525/7 prot., datë 03.06.2025, protokolluar me tonën me nr.1215/6, datë 04.06.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së dokumentet si vijon:

-Kërkesën për Informacion mbi ofertën anomalisht të ulët, që mban dt. 18.04.2025.

-Sqarim mbi ofertën anomalisht të ulët.

-Procesverbal mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës anomalisht të ulët të OE “LIBRARI DYRRAHU” Shpk.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre, që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi

paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti, nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejt me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët dhe se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik thekson se referuar nenit 2 germa “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. *Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm 7 përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.*

Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto

të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit rezulton, se argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi mori në shqyrtim dokumentet e përcjella nga autoriteti kontraktor konstaton, se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues të argumentimit të ofertës anomalisht të ulët me anë të cilit ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë.

Përveç kësaj, KPP vëren, se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk në mbështetje të deklarimeve më sipër, me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka paraqitur, një analizë për të gjithë artikujt objekt - prokurimi, duke detajuar analizën e kostos të artikujve që ka ofertuar.

Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të shoqëruara me dokumente provuese, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të germës a) të nenit 93 të LPP-së, ku flitet për anën ekonomikë të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës për të gjithë artikujt që merr nga OE të tjerë.

Pra, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, ka detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë.

- OBP_LOTI_I_formular_oferte_dhe_listë_çmimesh.
- OBP_LOTI_I_KATALOG.

Gjithashtu, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, ka argumentuar çmimet e ofertës së tij duke bashkëlidhur:

-Ofertë nga OE “IDEA-M” shpk me çmime për çdo artikull që siguron prej saj.

-Oferte nga OE “Global Grafika” shpk për artikujt që ofron me logo (çmime, shpenzime, dogana.

- Analiza kosto nga OE “IDEA M” shpk.(çmime , dogana per art e ofruar, shpenzime tjera.

-Analizë kosto nga OE “Global Grafika” shpk.

-Xhiro vjetore të viteve 2021-2024 me vlerat përkatëse të OE “LIBRARI DURRAHU” shpk.

Elemente të tjera favorizuese në përmbushje të kushtit për zgjedhje teknike të favorshme, si eksperiencia e gjatë në treg me aktivitet të gjatë:

-Realizime me sukses të shumë kontratave të ngjashme në kohë dhe me cilësi (cituara në materialin e operatorit ekonomik).

Punë të ngjashme paraqitura edhe në këtë procedurë.

Për sa i përket c) *originalitetit të punëve, mallrave dhe shërbimeve propozuar nga ofertuesi*, artikujt e ofruar nga ne janë sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 për cilësinë e dokumenteve të paraqitura në këtë procedurë prokurimi.

ç) *pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës*; Kompania jonë plotëson të gjitha detyrimet ligjore, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore apo edhe certifikimet sipas standardeve.

-ISO 9001 Për Menaxhimin e cilësisë dhe Sigurinë,

-ISO 45001 Për Menaxhimin e Sigurisë në Punë apo edhe,

-ISO 14001 Për Sistemin e Menaxhimin e Mjedisit.

Për të sqaruar në lidhje me pikën d) *mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore*, operatori jonë ekonomik nuk e ka të nevojshme.

Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të fakteve gjykon, se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së i ndryshuar, duke argumentuar në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij dhe duke analizuar në mënyrë të detajuar secilin prej tyre.

Argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës, duke ofruar shërbime/ punë/ mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Komisioni sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të lex specialis për prokurimin publik.

III.1.8. Përsa i përket argumenteve të Autoritetit Kontraktor:

Arsyet e skualifikimit:

[...]Nisur nga verifikimi i katalogut të dërguar në SPE, vërehet se OE vetëm për artikujt (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të DST), me nr. rendor 10, 12, 13, 14, 15, 17, 60, 61, ka deklaruar në katalog linkun web të subjektit “IDEA-M” shpk, ku mund të verifikohet specifikimet e artikujve të ofruara, ndërsa për të gjithë artikujt e tjerë OE ka deklaruar në katalog linqe web të subjekteve të tjera për të cilat nuk disponon asnjë dokumentacion provues bashkëpunimi apo furnizimi [...]

Dhe argumentet e përdorura nga KSHA:

Për më tepër KSHA konstatoi se edhe katalogu teknik i hartuar dhe nënshkruar nga OE ankimues nuk është konform me kërkesat e AK-së sipas pikës 2.3.8. të DST.

Pra OE nuk ka deklaruar subjektin “IDEA-M” shpk si prodhues edhe vetë ankimuesi e ka pranuar në ankesë.

Komisioni në shqyrtim të arsyes së skualifikimit nga KVO, gjykon se autoriteti kontraktor, në fazën e vlerësimit të ofertave duhej të analizonte përmbushjen e kriterit 2.3.8. dhe në çdo rast në referim të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ...Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, për një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm të ofertave, duhej të kërkonte sqarime mbi përmbushjen e kriterit kualifikues përpara se të kalonte në vlerësimin e anës ekonomike të ofertës së ankimuesit.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Më lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” Shpk me argumente si vijon:

Me datë 07.05.2025, AK ka publikuar njoftim fituesi shpallur paraprakisht fitues ofertuesit:

1- INPRESS SHPK;

2- Marketing & Distribution SHPK;

3- InfoSoft Office SHPK.

Në kushtet kur, kjo procedurë prokurimi është marrëveshje kuadër me disa operatorë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara pra, procedurë prokurimi me një fazë të dytë konkurimi atëherë statusi i ofertuesve të tjerë në këtë procedurë prokurimi çënon interesat e shoqërisë infosoft officeë shpk, pasi nëse këta ofertues janë të kualifikuar në mënyrë të padrejtë në fazën e parë të procedurës së prokurimit, bëhen pjesë e konkurimit në fazën e dytë të saj duke rrezikuar të përfitojnë kontratën dhe në këtë mënyrë çënojnë interesin e shoqërisë tonë në mënyrë të padrejtë

Në lidhje me vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ofertuesi INPRESS shpk, po ju parashtrojmë kundërshtimet tona si më poshtë vijojnë:

2.3.8 Për artikujt për të cilët nuk janë kërkuar mostra (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”), operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike, të lëshuara/ publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit.

OE me dokumentet e paraqitura nuk përmbush specifikimet teknike të artikujve për të cilët kërkohej kataloge/skeda teknike nga prodhuesi.

Ne besojmë se, ofertuesi “Inpress” shpk nuk ka arritur të paraqesë katalogët ose skedat teknike, të lëshuara ose të publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe me anë të së cilave të vërtetohet plotësimi i të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për artikujt për të cilët nuk i ka në objektin e veprimtarisë së tij prodhuese, ky ofertues nuk ka arritur të paraqesë katalog ose skeda teknike të lëshuara ose të publikuara nga prodhuesit e tyre.

Ne jemi të bindur se, kompania nga e cila ofertuesi ka paraqitur katalogët apo skedat teknike të artikujve, nuk është kompani prodhuese, por tregtuese. Mjafton të verifikohen katalogët apo skedat teknike të paraqitura nga kjo kompani dhe jemi të bindur se pretendimi ynë do të vërtetohet. Artikujt e pasqyruar në këta katalogë nuk reflektojnë markën e deklaruar nga kjo shoqëri, por janë të prodhuesve të tjerë.

Pra, nuk përputhet kompania e deklaruar si prodhuese, me produktin, që qartazi ne jemi të bindur se mban në trupin e vetë emrin e një tjetri prodhues. Gjithashtu ne besojmë se, po të verifikohen me kujdes katalogët dhe skedat teknike të paraqitura si katalog/ skeda teknike të prodhuesve të art. do të konstatohet lehtësisht që artikuj me nr. rendore 52 deri 54, dosje me numra të ndryshëm me zarfa plastik, fotoja e produktit (normalisht një katalog teknik ka dhe foto produkti), vërteton se prodhuesi i këtyre produkteve nuk është kompania e deklaruar si prodhuese nga ofertuesi “INPRESS” shpk, por një tjetër prodhues, prodhuesi real i këtyre artikujve. Në vijim të kësaj logjike ne jemi të bindur se, prodhuesi i deklaruar nga ofertuesi “Inpress” shpk, është i ndryshëm dhe nga prodhuesi i cili është i pasqyruar në trupin e mostrës me numër rendor 55 (Dosje me 80 zarfa plastik), produkt që normalisht ka të njëjtin prodhues, sikurse dhe artikujt 52 deri 54. Ne kërkojmë që KSHA-ja apo KPP-ja ta verifikojë këtë pretendim tonin ...

Kërkojmë të verifikohen nëse kompanitë nga të cilët OE ka paraqitur skeda apo katalogë janë ose jo prodhues..[..]

Për gjithë sa më sipër kërkojmë skualifikimin e ofertë së paraqitur nga ofertuesi “Inpress” shpk për mosplotësim të pikës 2.3.8 të kapaciteteve teknik të shtojcës 8 të dt-së.

III.2.1. Autoriteti kontraktor me vendimi e KSHA-së ka trajtuar ankesën dhe ka pranuar pjesërisht pretendimet si vijon:

KSHA mori ne shqyrtim dokumentacioni e paraqitur në SPE nga OE “Inpress” shpk e konkretisht katalogët teknike për artikujt:

- 1. Agjendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm me logo*
- 3. Agjendë ditore afërsisht 17.2x24 cm, me logo*
- 4. Agjendë ditore afërsisht 17.2x24 cm, pa logo*
- 58. Fletore, 32 faqe*
- 60. Fletore, 52 faqe*

Konstaton se nuk plotësohen numrat minimal të fletëve respektivisht për secilin artikull.

Për artikujt 5 dhe 7 cituar në ankesë nuk janë paraqitur sipas specifikimeve teknike.

KSHA konstatoi devijime, të cilat ndikojnë në karakteristikat funksionale dhe performancë duke u përbërë mangësi thelbësore dhe kusht skualifikimi.

Shmangia e përmbushjes së specifikimeve teknike, konkretisht nr. i fletëve ndikon në ofertë ekonomike e cila do jetë më ulët për shkak të mosrespektimit të specifikimeve teknike. Pra, vlera e ofertës ekonomike është e pazbatueshme praktikisht, pasi nuk përkon me sasinë reale të mallit të kërkuar në procedurë.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit për OE “INPRESS” shpk qëndron.

KSHA-Vendosi

- 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk.*

2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegime dhe dokumentacion përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qendror Blerës.

III.2.2. Neni 30 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.2.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.4. Referuar dokumenteve të dosjes rezulton se me datë 20.05.2025 operatori ekonomik i interesuar “INPRESS” shpk ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën nr.1264/2025 aplikuar në sistem në datën 16.05.2025 nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk.

III.2.5. Me shkresën Nr. 1264/4 Prot., datë 11.06.2025, drejtuar Autoritetit Kontraktor, për vënien në dijeni të operatorëve të interesuar e konkretisht të operatorit “INPRESS” shpk, mbi

vendimmarrjen e KSHA-së, Komisioni kërkoi dokumente provuese nëse OE ka marrë dijeni për Vendimin e KSHA-së mbi pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesit për skualifikimin e ofertës së operatorit “INPRESS” shpk.

III.2.5.1. Me shkresën me Nr.632/35 Prot., datë 13.06.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1264/5, datë 16.06.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë informacion në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

[...] Në përgjigje tuajës ju bëjmë me dije se Autoriteti Kontraktor pas vendimmarrjes së KSHA-së, respektivisht vendimin nr 32/2025, datë 27.05.2025, nga ana e personit përgjegjës për prokurimin janë marrë hapat për njoftimin e ankimuesit, operatorëve ekonomikë të interesuar dhe Komisionit të Prokurimit Publik.....

Për sa më sipër, lutemi gjeni bashkëlidhur kopje të librit të protokollit dhe dorëzimit me postë, ç’ka dëshmojnë zbatimin e detyrimit ligjor, për komunikimin dhe njoftimin e akteve administrative...[...].

III.2.6. Komisioni, në analizë të fakteve sipërcituar vëren, se operatori ekonomik i interesuar “INPRESS” Shpk, ka paraqitur pretendime për ankesën, në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. (cituar në pika II.12)

Referuar informacionit të Autoritetit Kontraktor, rezulton, se Vendimi i KSHA-së i është dërguar të gjitha palëve të interesuara sipas dispozitivit të tij (pika III.2.1.), si edhe referuar kthim përgjigjes së AK për vënien në dijeni të Vendimit të KSHA-së, palëve të interesuar me anë të së cilës ka përcjellë edhe dokumente provuese (cituar pika III. 2.5.1.).

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të fakteve të dosjes administrative konstaton, se operatori ekonomik “INPRESS” Shpk, ka paraqitur pretendime për ankesën, cituar më sipër në pikën II.12, në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por në referim të nenit 114, e konkretisht pikës 5 dhe 6 të tij në të cilën parashikohet shprehimisht se: “[...] 5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni. 6.Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik. [...]”, operatori ekonomik “INPRESS” Shpk nuk ka paraqitur ankesë, brenda afatit ligjor, në lidhje me argumentet paraqitur në sistem pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “INPRESS” Shpk nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të KSHA-së, brenda afateve të parashikuara në nenin 114, pika 5, të ligjit për prokurimin publik i ndryshuar.

Në përfundim, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe informacionit të paraqitur nga vetë operatori ekonomik “INPRESS” Shpk, në zbatim të nenit 115 pika 3/b) të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku citohet;

“3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” shpk, për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e tij, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit dhe operatori ekonomik i interesuar që ka paraqitur argumente, nuk ka paraqitur ankim në zbatim të nenit 114 pika 5, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” Shpk, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “INPRESS” Shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.3.1. Përsa referuar më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 dhe të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, Neni 45 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” Shpk, në lidhje me pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “INPRESS” Shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar” Marrëveshje kuadër me objekt Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, Loti 1 me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

III.4. Më lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” Shpk me argumente mbi operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” Shpk si vijon:

Me datë 07.05.2025, AK ka publikuar njoftim fituesi shpallur paraprakisht fitues ofertuesit:

1- INPRESS shpk.

2- Marketing & Distribution shpk.

3- InfoSoft Office shpk.

Në kushtet kur, kjo procedurë prokurimi është marrëveshje kuadër me disa operatorë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara pra, procedurë prokurimi me një fazë të dytë konkurimi atëherë statusi i ofertuesve të tjerë në këtë procedurë prokurimi cënon interesat e shoqërisë “Infosoft Office” shpk, pasi nëse këta ofertues janë të kualifikuar në mënyrë të padrejtë në fazën e parë të procedurës së prokurimit, bëhen pjesë e konkurimit në fazën e dytë të saj duke rrezikuar të përfitojnë kontratën dhe në këtë mënyrë çenojnë interesin e shoqërisë tonë në mënyrë të padrejtë...Në lidhje me vlerësimin e ofertës së paraqitur nga OE “Librari Dyrrahu” shpk, po ju parashtrojmë kundërshtimet tona si më poshtë vijnë:

Nga KVO është vendosur s'kualifikimi i ofertës së paraqitur për këtë procedurë prokurimi nga ofertuesi, për arsyen: Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit.

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtim/argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban çmimi i ofertës së deklaruar; Në dokumentacionin e paraqitur në SPE konstatohet se OE ka nënshkruar një akt-marrëveshje bashkëpunimi me subjektin "IDEA-M" sh.p.k, ku do furnizohet me të gjithë artikujt objekt prokurimi të këtij loti. Nisur nga verifikimi i katalogut të dërguar në SPE, vërehet se OE vetëm për artikujt (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 "Formulari i specifikimeve teknike" të DST), me nr. rendor 10, 12, 13, 14, 15, 17, 60, 61, ka deklaruar në katalog linkun web të subjektit "IDEA-M", ku mund të verifikohet specifikimet e artikujve të ofruara, ndërsa për të gjithë artikujt e tjerë OE ka deklaruar në katalog linqe web të subjekteve të tjera për të cilat nuk disponon asnjë dokumentacion provues bashkëpunimi apo furnizimi.

Në këto kushte, KVO konstaton një mospërputhje midis artikujve të deklaruar në katalog (të subjekteve të tjera) me artikujt e ofruar nga subjekti "IDEA-M" sh.p.k.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, të ndryshuar dhe arsyetimet e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" SH.P.K, me NUIS L91418502J.

[...] Pra sa më sipër, rezulton se OE "Librari Dyrrahu" shpk është kualifikuar nga KVO-ja, pra për KVO-në ky ofertues i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim, por është skualifikuar për shkak se ka rezultuar anomalisht i ulët dhe nuk ka arritur të argumentojë çmimet e tij të ofertës.

Ne pretendojmë se, ky vendim KVO-se në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE "Librari Dyrrahu" shpk është bërë në kundërshtim me Ligjin dhe Rregullat e prokurimit publik, me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, objekt i këtij ankimi dhe duhej të ishte skualifikuar për këtë shkak, pra për mosplotësimin e kriterëve për kualifikim dhe jo si një ofertë anomalisht e ulët për të cilën nuk ka arritur të argumentojë çmimet e tij.

Konkretisht, OE "Librari Dyrrahu" shpk nuk ka arritur të plotësojë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky ofertues nuk ka arritur të ofertojë me produkte të cilat të plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6 të dt-së, si dhe nuk ka arritur të plotësojë kriteret për kualifikim si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

2.3.8 Për artikujt për të cilët nuk janë kërkuar mostra (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”), operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike, të lëshuara/publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër kërkojmë të mbetet i skualifikuar dhe shtim arsye skualifikimi për OE “LIBRARI DYRRAHU” shpk për mospërmbushje të kriterëve 2.3.1. dhe 2.3.8. të Kapacitetit teknik.

III.4.1. Autoriteti kontraktor me vendimin Nr. 32/2025, datë 27.05.2025 të KSHA-së ka trajtuar ankesën dhe ka pranuar pretendimet e Operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk për mosplotësim të kriterëve kualifikuese sipërcituar në ankesë si më poshtë vijon:

[...] Operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk ka deklaruar në katalogun e paraqitur subjektin “IDEA-M” Shpk si prodhues nga i cili do të mundësojë një pjesë të konsideruar të artikujve pa paraqitur dokument tjetër mbështetës dhe provues, ka deklaruar se edhe në ankesën e tij se “IDEA-M” shpk nuk është prodhues, por shitës, pra është subjekt nga i cili OE ynë do të furnizohet, deklaratë që përforcon parregullsinë e katalogut të paraqitur kundrejt kërkesave dhe specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit. Lidhur me këtë fakt, pretendimet për mangësi të elementeve përmbajtës të katalogut teknik bëhen shterues në kuptimin e paraqitjes së argumenteve.

KSHA konstaton se OE ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Mospërputhje e subjektit deklarues si prodhues në katalog dhe subjektit me të cilin është paraqitur në marrëveshje tregon pamundësi për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Për me tepër KSHA konstaton faktin se jo vetëm është paraqitur ofertë anomalisht e ulët, por edhe e paargumentuar, **por edhe katalogu teknik i hartuar dhe nënshkruar nga OE ankimues nuk është konform kërkesave të përcaktuara në DT, sipas pikës 2.3.8. ...**

Pra, OE ka deklaruar në katalog subjektin “IDEA-M” shpk si prodhues nga i cili do të mundësojë një pjesë të konsiderueshme të artikujve pa paraqitur dokument tjetër provues mbështetës dhe provues. Në ankesë OE ka deklaruar se “IDEA-M” shpk nuk është prodhues, por shitës pra është subjekti nga i cili operatori ynë ekonomik do të furnizohet...”

Kjo deklaratë përforcon edhe më shumë parregullsi në katalog kundrejt kërkesave dhe specifikimeve teknike të DT. Lidhur me këtë fakt pretendimet për mangësi të elementeve përmbajtës të katalogut bëhen shterues në kuptimin e paraqitjes së argumenteve.

Përsa më sipër, pretendimi i OE ankimues qëndron.

Për këto arsye, KSHA

Vendosi

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk.

2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegime dhe dokumentacion përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qendror Blerës.

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumenteve të dosjes administrative konstaton, se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, pasi ka marrë dijeni për vendimin e KSHA-së, nuk ka paraqitur pretendime për ankesën, në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar” 1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të fakteve të dosjes administrative, gjykon se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, duke mos paraqitur argumente në lidhje me ankesën, ka humbur të drejtën e ankimit mbi vendimmarrjen e KSHA-së, në kuptim të nenit 113, “Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike. 2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”.

Komisioni gjykon se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, nuk ka paraqitur pretendime për ankesën, duke humbur të drejtën për ankesë në kundërshtim të Vendimit të

KSHA-së, në zbatim të nenit 114, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, të mbyllë çështjen në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK, për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e tij në lidhje me pretendimet skualifikim të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” Shpk, mbi skualifikimin e Operatorit Ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik do të mbetet i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit shprehur në ankesën e tij.

III.5.1. Përsa referuar më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 dhe të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 45 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” Shpk, në lidhje me pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar” Marrëveshje kuadër me objekt Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, Loti 1 me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” Shpk për procedurën e prokurimit sipërcituar në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar” Marrëveshje kuadër me objekt Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, Loti 1 me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë

letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” Shpk, në lidhje me pretendimet e ngritura për skualifikim të operatorit ekonomik “INPRESS” Shpk për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” Shpk, në lidhje me pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk për procedurën e prokurimit sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të ofertave mbi arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë “INPRESS” Shpk dhe “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, në zbatim të vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij vendimi.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin mbi zbatimin e Vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” Shpk.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” Shpk.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

